

## 1.3 miliard euro të humbura cdo vit si pasojë e prodhimit të pesticideve të falsifikuara

### **Prodhimi i pesticideve të falsifikuara i kushton bizneseve të BE 1.3 miliard euro cdo vit.**

Raporti më i fundit i Zyrës së Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Europian EUIPO tregon se 13.8% e të ardhurave të ligjshme humbin cdo vit për shkak të falsifikimit të pesticideve në 28 vendet e BE.

Këto humbje përkthehen në 2600 vende të humbura pune në sektorin e prodhimit të pesticideve në BE, kjo pasi prodhuesit legjitimë punësojnë më pak njerëz nga sa do të mund të punësonin nëse falsifikimi i pesticideve nuk do të egzistonte.

Nga koha kur kanë filluar të analizohen efektet e hedhjes në treg të pesticideve të falsifikuara, janë humbur 11 700 vende pune në BE.

Humbja totale vjetore e të ardhurave të qeverisë, si rezultat i produkteve të falsifikuara në këtë sektor në të gjithë 28-shen e BE-së, për sa i përket taksave dhe kontributeve shoqërore është vlerësuar në € 238 milionë euro.

Drejtori ekzekutiv i EUIPO, António Campinos tha:

*Ashtu si raporti jonë ka treguar, falsifikimi mund të ndikojë në cdo sektor ekonomik dhe industria e prodhimit të pesticideve, e cila përfshin një numër të madhë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nuk bëjnë përjashtim. Ky është raporti i dhjetë në serinë tonë të studimit dhe përshkruan efektin ekonomik të prodhimit të pesticideve të falsifikuara, pasojën e humbjes së vendeve të punës, si edhe se si prodhuesit e ligjshëm janë të kushtëzuar nga prania e produkteve të falsifikuara në treg.*

Ky raport është i dhjeti në një seri studimesh të publikuara nga EUIPO përmes Observatorit Europian për Shkelje të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale në ndikimin ekonomik që ka falsifikimi në sektorët industrial në BE.

Këto seri raportesh kanë pasur në fokus: sektorin farmaceutik, sektorin e prodhimit të verërave, sektorin e muzikës së regjistruar, sektorin e cantave të dorës dhe të valixheve, sektorin e orave dhe të bizhuterive, të rrobave, sporteve, lodrave, këpucëve dhe kozmetikës.

Gjermania: Gjermania është prodhuesi më i madh i pesticideve në BE me vlerë 4 miliard euro. Raporti vlerëson se pesticidet e falsifikuara i kushtojnë sektorit të prodhimit gjerman 299 milion € në vit, dhe 500 vende pune të humbura.

Franca : Franca është prodhuesi i dytë më i madh i pesticideve në Evropë me vlerë 3,5 miliardë euro. Raporti vlerëson se sektori i pesticideve humbet një vlerë € 240 milion në shitje dhe 500 vende pune çdo vit për shkak të falsifikimit.

Itali: Raporti vlerëson se sektori i pesticideve në Itali humb 185 milionë €, si dhe 270 vende pune në vit.

Spanjë: Raporti vlerëson se sektori i pesticideve në Spanjë humbet 94 milion €, si dhe 200 vende pune në vit.

Britani e Madhe: Raporti vlerëson se sektori i pesticideve në Britaninë e Madhe humbet 76 milion € si edhe 200 vende pune në vit.

### **SHËNIM PËR REDAKTORËT**

Raporti i sotëm është i dhjetë në një seri të raporteve sektoriale për ndikimin që ka falsifikimi në ekonomi. Raportet e ardhshme do të studiojnë sektorët e tjerë të tilla si smartphones, pjesët e automobilave dhe sektorë të tjerë.

### **RRETH EUIPO**

EUIPO është një agjenci e decentralizuar e BE-së, me seli në Alicante, Spanjë.

Ajo menaxhon regjistrimin e markës tregtare së Bashkimit Evropian (EUTM) dhe regjistrimin e disenjës në Komunitet (RCD), dy prej të cilave sigurojnë mbrojtjen e pronësisë intelektuale në të gjitha shtetet anëtare të 28-shes të BE-së, si dhe kryerjen e aktiviteteve të bashkëpunimit me zyrat kombëtare dhe rajonale të PI së BE-së.

Deri më 23 mars 2016, EUIPO ishte i njohur si Zyra për Harmonizimin në Tregun e Brendshëm (OHIM).

**Observatori Evropian** për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale është themeluar në vitin 2009 për të mbështetur mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe për të luftuar kërcënimin e shkeljeve të PI në Evropë. Ai u transferua në EUIPO më 5 qershor me Rregulloren e (BE) Nr 386/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.